



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 1293 prot.

Himarë, më 05.02.2025

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE PËR POZICIONIN PUNONJËS I POLICISË BASHKIAKE NË DREJTORINË E POLICINË BASHKIAKE

Në zbatim të ligjit nr. 89/2022, “Për policinë bashkiake”, vendimit nr. 452, datë 26.07.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullorës kuadër të policisë bashkiake”, si dhe vendimit nr. 2, datë 31.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Himarë për vitin 2025”, drejtoria e burimeve njerëzore, informacionit dhe shërbimeve digjitale, njofton shpalljen për:

5 (pesë) vende të lira pune në pozicionin: Punonjës i policisë bashkiake – në drejtorinë e policisë bashkiake

Afati për dorëzimin e dokumenteve është deri më datën: 07.03.2025

1. Kompetencat dhe detyrat e policisë bashkiake

1. Policia bashkiake ka këto kompetenca dhe detyra, në përputhje edhe me aktet e tjera rregullatore:

a) siguron zbatimin e akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak;
b) parandalon, konstaton dhe shqyrton kundërvajtjet administrative përmes forcimit, inspektimit dhe monitorimit në zbatim të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brenda territorit të juridiksionit të saj.

2. Në fushën e rendit dhe sigurisë në komunitet, policia bashkiake:

a) merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile pranë bashkisë dhe prefektit të qarkut për kapërcimin e tyre;
b) kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridiksionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit;
c) vendos kufizimin e qarkullimit në rrugë jashtë qendrave të banuara për ditët e festave lokale në bashkëpunim me organet e Policisë Rrugore;

- c) bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikëqyrjen e sigurisë brenda territorit të juridiksionit të saj;
- d) bashkërendon masat me Policinë e Shtetit për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteve në territorin e juridiksionit të bashkisë;
- dh) verifikon zbatimin e ligjshmërisë dhe patrullimin periodik në bashkëpunim me Policinë e Shtetit përgjatë vijës bregdetare publike dhe në zonat çlodhëse të ujërave të brendshme në thellësi të territorit, për sigurinë në det, plazhe dhe në ujërat e brendshme në thellësi të territorit të juridiksionit të bashkisë;
- e) monitoron respektimin e ndarjes së hapësirës së plazhit gjatë ushtrimit të veprimtarisë të çdo personi juridik apo fizik pranë stacioneve të plazhit në territorin e juridiksionit të bashkisë;
- ë) merr masa sigurie në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre si personel sigurie;
- f) mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, për procedurat e zhvendosjes së individëve ose familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre;
- g) merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë, si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.

3. Në fushën e bashkëjetesës shoqërore, policia bashkiake:

- a) mbikëqyr respektimin e normave etike detyruese të bashkëjetesës, të përcaktuara në rregulloren e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;
- b) mbështet organet e inspektimit për zbatimin e legjislacionit për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;
- c) siguron ekzekutimin e sanksioneve për lidhjen dhe zgjidhjen e kontratës së qirasë së banesave sociale me qira dhe kufizimet mbi banesat me kosto të ulët, të vendosura nga entet menaxhuese.

4. Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, policia bashkiake:

- a) bashkërendon punën me strukturat përkatëse kur konstaton veprimtari të paligjshme për mjedisin, natyrën, pyjet, biodiversitetin dhe florën e faunën e egër;
- b) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të kontrollit mbi gjuetinë kur pengohen në kryerjen e detyrës;
- c) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të inspektimit që mbulojnë veprimtarinë e peshkimit;
- ç) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit për mbrojtjen e liqeneve ndërkuftare, brigjeve të tyre, zonave ujëmbledhëse, si dhe veprimtaritë që ushtrohen në to;
- d) verifikon dhe kontrollon zbatimin e kërkesave mbi nivelin kufi të zhurmës së lejuar nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurma, në territorin e juridiksionit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për zhurmat.

5. Në fushën e veprimtarisë ekonomike dhe tregtare, policia bashkiake:

- a) siguron zbatimin e akteve që përcaktojnë kryerjen e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, në vende publike të përcaktuara paraprakisht nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- b) verifikon respektimin e normave ligjore në lidhje me përdorimin në tregje apo vende të autorizuara nga bashkia të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo- degradueshme apo të oxo-biodegradueshme dhe vendosjen e materialeve reklamuese të pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë

sheqer të shtuar drejtuar të miturve;

c) mbështet strukturat përgjegjëse të taksave dhe tarifave vendore në veprimtarinë e tyre.

6. Në fushën e mbrojtjes së shëndetit, policia bashkiake siguron respektimin e normave ligjore në lidhje me ndalimin e përdorimit të duhanit në mjetet e transportit publik, përfshirë taksitë dhe mjediset e përbashkëta, në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme.

7. Në fushën e ruajtjes së hapësirës publike, policia bashkiake:

a) siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;

b) vëren dhe konstaton ndërtimet e kundërligjshme, njofton dhe mbështet menjëherë strukturën përgjegjëse ndërtimore e urbanistike të bashkisë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore;

c) siguron zbatimin e rregullave dhe procedurave për organizimin dhe funksionimin e shërbimit publik të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e juridiksionit të bashkisë;

ç) garanton zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi afishimin e materialeve propagandistike në vendet jashtë përcaktimeve të bëra, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore.

2. Kriteret për pranimin e kandidatëve në policinë bashkiake:

Kandidati për pranimin në Policinë Bashkiake duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm të lartë;

d) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

e) të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;

3. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë;

a) kërkesën;

b) jetëshkrimin;

c) fotokopjen e kartës së identitetit;

d) fotokopjet e noterizuara të diplomës të arsimit të mesëm të lartë;

e) 2 (dy) foto me përmasa 4 x 6 cm;

f) raportin mjekoligjor mbi gjendjen shëndetësore;

g) certifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);

- h) vërtetimin nga prokuroria për qenien ose jo në ndjekje penale;
- i) vërtetimin nga gjykata për çështje në proces gjykim;
- j) dokumentet për vërtetimin e përvojës në punë apo librezën e punës;
- k) vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata publike;
- l) vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda datës 07.03.2025.

Në përfundim të afatit të verifikimit paraprak nga Komisioni i përzgjedhës, *drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse* do të shpallë në faqen e internetit të Bashkisë Himarë dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër si dhe për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Bashkisë Himarë. Afati i ankimit është 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

4. Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:

- Njohuritë mbi ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Njohuritë mbi vendimin nr.452, datë 26.07.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullorës kuadër të Policisë Bashkiake”;

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në këto faza të konkurimit:

- **Testim me shkrim deri në 60 pikë**

Testimi me shkrim kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga shpallja e listës së kandidatëve, që plotësojnë kriteret ligjore për t’u pranuar në policinë bashkiake. Rezultatet e testimit me shkrim dalin brenda ditës së testimit. Kandidati nuk kualifikohet për vazhdimin e konkurimit nëse nuk merr 60% të pikëve të përcaktuara. Kandidati që merr më shumë 60% të pikëve të përcaktura të testimit do të do të njoftohen me anë të postës elektronike për të vazhduar procesin e intervistës.

- **Testimi i aftësive fizike, 20 (njëzet) pikë;**

Testimit fizik u nënshtrohen të gjithë kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me

shkrim për pranim në policinë bashkiake. Rezultatet e testimit fizik dalin brenda ditës së testimit. Njësia e burimeve njerëzore njofton individualisht kandidatët që nuk janë kualifikuar për arsyet e moskualifikimit. Në përfundim të vlerësimit të testimit të aftësive fizike, lista me rezultatet e testimit në rend zbritës publikohet në ambientet dhe në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse.

- **Intervista me gojë deri në 20 pikë**

Kandidatët, që rezultojnë fitues në fazat e tjera të testeve, i nënshtrohen intervistës, e cila zhvillohet nga komisioni përzgjedhës.

Intervista konsiston në aftësinë e kandidatit për të komunikuar qartë, për të analizuar e për të marrë vendime, si dhe për të reaguar në mënyrën e duhur në situata të caktuara.

Në këtë fazë konkurrimi, totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 20 (njëzet) pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

a) jetëshkrimi (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, deri në 10 pikë;

b) intervista, deri në 10 pikë.

Komisioni bën vlerësimin e kandidatëve brenda ditës së zhvillimit të intervistës dhe njësia e burimeve njerëzore njofton kandidatët për vlerësimin të nesërmen e zhvillimit të testimit. Në përfundim të vlerësimit të intervistës, lista me rezultatet e testimit në rend zbritës publikohet në ambientet dhe në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse.

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim, testimit fizik dhe rezultatit të intervistës me gojë. Kandidati që merr më shumë se 60 pikë në të tre fazat konsiderohet i suksesshëm. Kandidatët, që kanë marrë më pak se 60 pikë, renditen në një listë të posaçme që nuk bëhet publike dhe ata njoftohen individualisht nga drejtorja e burimeve njerëzore.

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himarë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për vlerësimin përfundimtar. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Bashkisë Himarë. Afati i ankimit është 5 ditë nga data e shpalljes dhe njoftimit të rezultateve të testimit.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo



Handwritten signature or initials, possibly "M. J. ...".